



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Nr. ____ .prot

Berat, më ____ . ____ .2024

RELACION

MBI MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË RREGULLORES “PËR KUSHTET DHE RREGULLAT E ZËNIES SË HAPSIRËS PUBLIKE NË BASHKINË E BERATIT”.

Të nderuar këshilltarë !

Jemi sot përpara jush për të kërkuar ndryshim në VKB nr. 42 datë 29.06.2020 mbi “Rregulloren për kushtet dhe rregullat e zënies së hapsirës publike në bashkinë e Beratit” Neni 5/2 *ishte* : “Afati maksimal i marrveshjes për përdorimin e hapsirës publike nuk mund të jetë më shumë se një vit nga data e nënshkrimit nga palët”.

Neni 5/2 *bëhet* : “Afati për përdorimin e hapsirës publike fillon nga data e nënshkrimit të saj sipas aktmarrveshjes dhe faturohet njësoj si taksat dhe tarifat e tjera vjetore që mbart subjekti”.

Neni 14/1 *ishte* : “Afati i marrveshjes për këto kategori aktiviteteve është deri në një vit. Neni 14/1 *të shfuqizohet, shih nenin 5 pika 2.*

Neni 47/4 *ishte* : “Leja do të lëshohet me një afat deri në një vit, por sipas kërkesës mund të jetë edhe për periudha sezonale”

Neni 47/4 *të shfuqizohet, shih nenin 5 pika 2.*

Neni 66/4 *ishte* “Për këtë kategori aktiviteti afati i lejes/marrveshjes për zënien e hapsirës publike është deri në një vit”.

Neni 66/4 *të shfuqizohet pjesa e parë, shih nenin 5 pika 2.*

Arsyeja e ndryshimit të këtij neni ka të bëjë me arsyetimin se subjekti nuk ka pse të aplikoj për hapsirë publike çdo vit, të bëjë kërkesë çdo vit, ti behet miratim çdo vit...etj.

Arsyeja e ndryshimit lind dhe si rezultat i kërkesës nga subjekti por edhe si nevojë nga drejtoria e taksave dhe tarifave, sepse drejtoria e taksave dhe tarifave shih një specialist i cili është i investuar gjatë gjithë vitit duke përgatitur dokumentacionin përkatës ndërkohë që me këtë aktmarrëveshje të re ne bëjmë që ti përgjigjemi qytetarit në një kohë më të shpejt dhe nga ana tjetër maksimizojmë të ardhurat tona në zërin “*të ardhura nga zënia e hapsirave publike*”.

Subjekti sërish do të aplikoj pranë zyrës sonë me një ndalesë për t’u pajisur me hapsirë publike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Sipas VKB nr. 42 datë 29.06.2020 mbi “Rregulloren për kushtet dhe rregullat e zënies së hapsirës publike në bashkinë e Beratit” drejtoria përkatëse do të bëjë miratim ose jo të kërkesës, e nëse ndodh që subjektit i miratohet kërkesa mbi “hapsirën publike” ai do të thërritet (vetëm një herë) pranë zyrës së regjistrimit në drejtorinë e taksave dhe tarifave për të nënshkruar akt-marrvëshjen, akt marrvëshje e cila do të regjistrohet dhe do të përfundojë me mbylljen/pezullimin e niptit të subjektit, ose me kërkesë të tij.

Bashkëngjitur këtij relacioni shpjegues po ju vëmë në dispozicion një kopje të akt-marrvëshjes përkatëse.

Duke ju falenderuar,

Grupi i punës :

Kryetari :

z. Ervin DEMO

Drejtoria e planifikimit urban, lejeve dhe investimeve :

znj. Etleva DHIMA

Drejtoria e taksave dhe tarifave :

z. Ardit NONAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Nr. ____ .prot

Berat, më ____ . ____ .2024

RELACION

MBI NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 93 DATË 28.12.2021 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E BERATIT”.

Të nderuar këshilltarë !

Jemi sot përpara jush për të kërkuar një ndryshim në VKB nr. 93 datë 28.12.2021 mbi “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Beratit”

Neni 58 paragrafi 2 *ishte* : “Për kategorinë III rezervim të vendeve të parkimit dhe kategorinë V Abonime detyrimi paguhet me një këst të vetëm, i cili paguhet menjëherë pas konfirmimit të kërkesës së subjektit/personit”.

Neni 58 paragrafi 2 *bëhet* : “Për kategorinë III rezervim të vendeve të parkimit dhe kategorinë V abonime, detyrimi i tij do të paguhet në një këst të vetëm brënda datës 20 Prill, detyrim ky që lind me lidhjen e akt-marrveshjes dhe faturohet njësoj si taksat dhe tarifat e tjera vjetore që mbart subjekti.”

Arsyeja e ndryshimit të këtij neni ka të bëjë me arsyetimin se subjekti nuk ka pse të aplikoj për vendparkim çdo vit, të bëjë kërkesë çdo vit, ti behet miratim çdo vit...etj.

Arsyeja e ndryshimit lind dhe si rezultat i kërkesës nga subjekti por edhe si nevojë nga drejtoria e taksave dhe tarifave, sepse drejtoria e taksave dhe tarifave sheh një specialist i cili është i investuar gjatë gjithë vitit duke përgatitur dokumentacionin përkatës ndërkohë që me këtë aktmarrveshje të re ne bëjmë që ti përgjigjemi qytetarit në një kohë më të shpejt dhe nga ana tjetër maksimizojmë të ardhurat tona në zërin “*të ardhura nga parkingu*”.

Subjekti sërish do të aplikoj pranë zyrës sonë me një ndalesë për t’u pajisur me vendparkim.

Sipas pikës 2 të nenit 59 të VKB nr. 93 datë 28.12.2021 mbi “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Beratit” drejtoria përkatëse do të bëjë miratim ose jo të kërkesës, e nëse ndodh që subjektit i miratohet kërkesa mbi “vendparkimin” ai do të thërritet (vetëm një herë) pranë zyrës së regjistrimit në drejtorinë e taksave dhe tarifave për të nënshkruar akt-marrveshjen, akt marrveshje e cila do të regjistrohet dhe do të përfundojë me mbylljen/pezullimin e niptit të subjektit, ose me kërkesë të tij.

Bashkëngjitur këtij relacioni shpjegues po ju vëmë në dispozicion një kopje të akt-marrveshjes përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Duke ju falenderuar,

Grupi i punës :

Kryetari :

z. Ervin DEMO

Drejtoria e planifikimit urban, lejeve dhe investimeve :

znj. Etleva DHIMA

Agjensia e shërbimeve publike :

znj. Joana MELENGU

Drejtoria e taksave dhe tarifave :

z. Ardit NONAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E ARSIMIT

**RELACION MBI MIRATIMIN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN
ARSIMOR 2024-2025**

Të nderuar këshilltarë

Mbështetur në:

VKM Nr.666, datë 10.10.2019 të ndryshuar me **VKM Nr.511, datë .27.7.2022** “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënës të arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të vecanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”

VKM Nr.854, datë 24.12.2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në **VKM Nr.666, datë 10.10.2019** “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënës të arsimit parauniversitar në institucionet e arsimore publike” të ndryshuar.

a) në pikën 9 të të cilit shprehimisht citohet se : “Bursat e nxenesve për vitin e parë shqyrtohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak sipas vendbanimit të përhershëm të prindit/nxënës, përfitues të bursës/kuotës ushqimore “

b) Në pikën 4 të të cilit shprehimisht citohet se : “ Njesitë e vetëqeverisjes vendore , për uljen e nivelit të braktisjes shkollore për nxënës që janë rregjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënës, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor , si dhe nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar.

c) Në pikën 10.1. të të cilit shprehimisht citohet se:” Bursat e nxënësve për vitin e dytë e lart rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga Këshilli Bashkiak, sipas vendodhjes territoriale e administrative të shkollave profesionale apo konvikteve ku janë vendosur nxënës, përfitues të bursës/ kuotës ushqimore , sipas planit të bursave të miratuara në vitin paraardhës nga Këshilli Bashkiak i njesive të vetëqeverisjes vendore “

Gjithashtu duke u mbështetur në:

- Në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit protokolluar me tonen nr.684 prot, datë 25.11.2024 “Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënës, të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar,për vitin shkollor 2024-2025” (**80 bursa në total**)
- Në shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë protokolluar me tonën nr.646 prot datë 04.11.2024 “Dërgohet plani i shpërndarjes së bursave për nxënës që

ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2024-2025" (**60 bursa për nxënësit e klasave të X-ta**)

Komisioni "Për verifikimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit për bursat e nxënësve të arsimit parauniversitar" i ngritur nga Kryetari i Bashkisë me urdhër nr.710 dt 24.10.2024, mori në shqyrtim të gjitha kërkesat për bursa të dorezuara nga nxënësit e AML.

Pas verifikimeve komisioni hartoi listen e përfituesve sipas kritereve të percaktuara në ligj dhe vendosi që të propozojë për miratim:

- **Gjithsej 274 (dyqind e shtatëdhjet e kater) bursa per nxënësit nga shkollat e mesme te përgjithshme , shkollat 9 vjecare (MASR) dhe shkollat e mesme profesionale (MFE), të cilët plotësojnë kriteret për të qënë përfitues**

Shperndarja eshte si vijon:

1- 63 (gjashtëdhjet e tre) bursa, per aplikantet nga klasat e X (viti i pare) dhe aplikantët për herë të parë në klasat XI-XIII për MFE dhe MASR nga këta:

- a) 59 (pesëdhjet e nëntë) bursa të plota
- b) 4 (katër) bursa 50% (gjysëm burse)

1.1 2 (dy) nxënës aplikantë për herë të parë të cilët i perkasin shkollave të mesme profesionale (MFE).

1.2 61 (gjashtëdhjet e një) nxënës aplikantë nga klasat e X (viti i pare) nga këta:

1.2.1 49 (dyzet e nëntë) i perkasin shkollave të mesme profesionale (MFE) nga të cilët :

- a) 45 (dyzet e pesë) janë përfitues të bursës së plotë
- b) 4 (ktër) janë përfitues me 50% (gjysëm burse) sipas -

2.1.2 12 (dymbëdhjetë) i perkasin shkollave të mesme të përgjithshme (MASR) janë përfitues të bursës së plotë.

2. 179 janë nxënës aplikante si ish përfitues nga vitet shkuara të cilëve nuk i kanë ndryshuar kriteret, nga këta :

2.1 33 (tridhjet e tre) aplikantë nga shkollat e mesme të përgjithshme (MASR)

2.2 146 (njëqind e dyzet e gjashtë) aplikante nga shkollat e mesme profesionale (MFE) nga të cilët 126 (njëqind e njizet e gjashtë) përfitues të bursës së plotë dhe 20 (njëzet) përfitues gjysëm burse.

3. 32 janë nxënës përfitues të propozuar nga ZVA në shkresën me Nr.1524 prot, Date 13.12.2024 si nxënës, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk e ndjekin arsimin bazë.



Kuotat në dispozicion:

MASR: 80 gjithsej (klasa

X e lart)

MFE : 60 vetem per klasat e X-ta

Nr	Kategorite	MFE	MASR	TOTALI
1	Aplikant klasa e X-të	49 (45 bursa te plota, 4 bursa 50%)	12	61
2	Aplikant për herë të parë klasa XI-XIII	2	0	2
3	Ish përfitues	146 (126 bursa te plota, 20 bursa 50%)	33	179
4	Arsimi 9-vjecar		32	32
5	Totali	195	77	274

Po ju paraqesim për miratim dhënien e bursave për nxenesit , të cilët plotesojnë kriteret përkatëse për të qënë përfitues të bursës, bazuar në ligj dhe në planin e percaktuar nga ministritë përkatëse , sipas listës bashkëlidhur

DREJTORI

Klodjana Hoxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E MENAXHIMIT FINANCIAR DHE TË ARDHURAVE

Berat, më /12/2024

RELACION

“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028”

Të nderuar këshilltarë !

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 34 pika 6, neni 41 pika 1, neni 54 pika dh, neni 64 pika c të Kreut X, i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore“ neni 33, 34, 35 36, 37, 38, 39. Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; me ndryshimet e bëra. Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 9 datë 20.03.2018 “ Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”,

- Ju paraqesim për miratim Kalendarin “Për procedurat standarte për përgatitjen e kërkesave të programit buxhetor afatmesëm 2026 -2028” sipas tabelës bashkëlidhur.

Ju faleminderit !

Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Rovena Shehu